

STATUTI

I

UNIVERSITETIT TË ELBASANIT

"ALEKSANDËR XHUVANI"

(Ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 6 datë 17.02.2022)



PËRMBAJTJA

KREU I: PARIME THEMELORE

Neni 1: Të përgjithshme.....	1
Neni 2: Misioni.....	1
Neni 3: Akronime.....	2
Neni 4: Përkufizime.....	2

KREU II: ORGANIZIMI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV I UE

Neni 5: Struktura e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”	3
Neni 6: Organet dhe autoritetet drejtuese në UE.....	5
Neni 7: Organigrama e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”	6

KREU III: ORGANIZIMI AKADEMIK NË UE

Organe dhe autoritete drejtuese	
Neni 8: Senati Akademik.....	7
Neni 9: Funkcionet e Senatit Akademik	7
Neni 10: Rektori.....	9
Neni 11: Funkcionet e rektorit	9
Neni 12: Rektorati	10
Neni 13: Funkcionet e rektoratit	11
Neni 14: Zëvendësrektorët.....	11
Neni 15: Asambleja e personelit akademik	12
Neni 16: Drejtuesi i njësisë kryesore	12
Neni 17: Funkcionet e drejtuesit të njësisë kryesore	12
Neni 18: Dekanati.....	13
Neni 19: Funkcionet e dekanatit	13
Neni 20: Zëvendësdekani	14
Neni 21: Drejtuesi i njësisë bazë.....	14
Neni 22: Funkcionet e drejtuesit të njësisë bazë.....	15
Organe të tjera kolegiale të përhershme	
Neni 23: Këshilli i Etikës i UE-së.....	16
Neni 24: Komisionet e përhershme.....	17

KREU IV: ORGANIZIMI ADMINISTRATIV I UE

Organe dhe autoritete drejtuese administrative të UE-së	
Neni 25: Bordi i administrimit i UE-së	19
Neni 26: Funkcionet e Bordit të Administrimit të UE-së.....	19
Neni 27: Administratori i UE-së.....	20
Neni 28: Funkcionet e administratorit të UE-së.....	20
Neni 29: Mbarimi i parakohshëm i mandatit të autoriteve drejtuese dhe anëtarëve të zgjedhur të organeve drejtuese të institucionit publik të arsimit të lartë.....	21

KREU V: PERSONELI I UE-së

Neni 30: Personeli i UE-së.....	22
Neni 31: Kategoritë e personelit akademik të UE-së.....	22



Neni 32: Titujt akademikë.....	23
Neni 33: Fitimi i titujve akademikë.....	23
Neni 34: Personeli akademik i ftuar.....	24
Neni 35: Viti akademik sabatik.....	24
Neni 36: Personeli ndihmësakademik.....	24
Neni 37: Personeli administrativ.....	25

KREU VI: PUNËSIMI NË UE

Neni 38: Punësimi i personelit akademik.....	26
Neni 39: Punësimi i personelit ndihmësakademik.....	26
Neni 40: Punësimi i personelit administrativ.....	27
Neni 41: Përgjegjësia për masat disiplinore për personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ.....	27
Neni 42: Lloji i masave disiplinore.....	28
Neni 43: Masat disiplinore për personelin administrativ.....	28
Neni 44: Parashkrimi i masave disiplinore.....	28
Neni 45: Përfundimi i marrëdhënieve të punës.....	29

KREU VII: PROGRAMET E STUDIMIT DHE ORGANIZIMI I TYRE

Neni 46: Format e studimeve dhe pranimi i studentëve.....	30
Neni 47: Ciklet dhe programet e studimeve.....	30
Neni 48: Programet e ciklit të parë të studimeve.....	30
Neni 49: Pranimi në ciklin e parë të studimeve.....	31
Neni 50: Programet e ciklit të dytë të studimeve.....	32
Neni 51: Pranimi në ciklin e dytë të studimeve.....	32
Neni 52: Programet e ciklit të tretë të studimeve.....	32
Neni 53: Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve.....	33
Neni 54: Zhvillimi i studimeve të doktoratës.....	33
Neni 55: Programet e përbashkëta të studimit.....	33
Neni 56: Programet e studimit në fushën e mësuesisë.....	34
Neni 57: Ndjekja e një programi të dytë studimi.....	34
Neni 58: Transferimi i studimeve.....	34
Neni 59: Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies.....	35
Neni 60: Kohëzgjatja e studimeve.....	35
Neni 61: Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomës.....	35

KREU VIII: KËRKIMI DHE VEPRIMTARIA SHKENCORE

Neni 62: Veprimtaria kërkimore shkencore.....	37
Neni 63: Realizimi i kërkimit shkencor.....	37
Neni 64: Financimi i kërkimit shkencor.....	38
Neni 65: Etika në kërkimin shkencor në UE.....	38

KREU IX: STUDENTËT, TË DREJTAT, DETYRIMET DHE TË DHËNAT PËR TA

Neni 66: Fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të studentit.....	39
Neni 67: Të drejtat dhe detyrimet e studentëve.....	39
Neni 68: Këshillat e studentëve.....	40



Neni 69: Dokumentacioni i procesit mësues.....	40
Neni 70: Baza e të dhënave të studentëve.....	41
KREU X: SIGURIMI I CILËSISË	
Neni 71: Sigurimi i brendshëm i cilësisë.....	42
KREU XI: PRONAT & FINANCIMI I UE-së, MARRËDHËNIET ADMINISTRATIVE DHE FINANCIARE	
Neni 72: Pronat e UE-së.....	43
Neni 73: Autonomia financiare e UE-së.....	43
Neni 74: Burimet e financimit të UE-së.....	43
Neni 75: Fondet nga buxheti i shtetit.....	44
Neni 76: Marrëdhëniet financiare.....	44
Neni 77: Auditimi i brendshëm.....	44
KREU XII: DISPOZITA PROCEDURIALE	
Neni 78: Vendimmarrja.....	45
Neni 79: Krjimi i Komisioneve <i>ad hoc</i> në nivel institucioni.....	45
DISPOZITA TË FUNDIT	
Neni 80: Vula dhe stema e institucionit.....	46
Neni 81: Vazhdueshmëria.....	46
Neni 82: Miratimi.....	46
Neni 83: Hyrja në fuqi.....	46



KREU I PARIME THEMELORE

Neni 1 Të përgjithshme

1. Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" është institucion publik i arsimit të lartë.
2. Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" është person juridik publik, që financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme.
3. Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 414, dt.12.11.1991. Universiteti i Elbasanit është vazhdues i Institutit të Lartë Pedagogjik "Aleksandër Xhuvani" (ILP) themeluar më 1971, i cili u përvijua si vazhdues i drejtpërdrejtë i Shkollës Normale të Elbasanit (i pari institucion kombëtar i përgatitjes së mësuesve në Shqipëri, themeluar më 1909).
4. Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" organizohet dhe funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet nënligjore dhe legjislacionin në fuqi.
5. Selia ligjore e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" është rektorati me adresë: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan.
6. Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" (UE) ka stemën, flamurin dhe vulën e tij, të cilat janë sipas shtojcave bashkëlidhur këtij statuti.
7. Statuti i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" është dokumenti bazë i veprimtarisë së Universitetit.

Neni 2 Misioni

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", si institucion i arsimit të lartë ka për mision:

- a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet;
- b) të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend;
- c) të ofrojë mundësi të barabarta për të përfitur nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- d) të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare;
- e) të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit;
- f) të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor;
- g) të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë.



Neni 3

Akronime

Në këtë Statut termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “UE” është akronimi i emrit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.
2. “FSHH” është akronimi i emrit të Fakultetit të Shkencave Humane.
3. “FSHN” është akronimi i emrit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës.
4. “FSHE” është akronimi i emrit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit.
5. “FSHMT” është akronimi i emrit të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike.
6. “FE” është akronimi i emrit të Fakultetit Ekonomik.

Neni 4

Përkufizime

Termet në vijim, kanë kuptimin si më poshtë:

1. “Student” është kandidati i shpallur fitues, i cili regjistrohet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi dhe është pajisur me numër të veçantë matrikullimi nga QSHA.
2. “Viti Akademik” do të thotë periudha kohore e zhvillimit të procesit mësimor, i organizuar në semestra, i cili përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.
3. “Tarifat” do të thotë tarifa e shkollimit si dhe tarifa të tjera të miratuara nga organi kompetent, sipas legjislacionit në fuqi.
4. “Regjistrimi” do të konsiderohet procedura e përcaktuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
5. “Aktet rregullatore” janë dokumentacioni që rregullon veprimtarinë e UE së, të miratuara nga organet përkatëse, në zbatim të legjislacionit dhe statutit.



KREU II
ORGANIZIMI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV I UNIVERSITETIT TË
ELBASANIT

Neni 5

Struktura e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

(Ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 6 datë 17.02.2022)

1. UE është institucion i arsimit të lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale.
2. UE përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera.
3. Struktura akademike në nivel institucioni në UE janë:
 - a. Senati Akademik i UE-së;
 - b. Rektorati;
 - c. Rektori;
 - d. Zëvendësrektori/ët.
4. UE ka në përbërje 5 (pesë) njësi kryesore:
 - a. Fakulteti i Shkencave të Natyrës;
 - b. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;
 - c. Fakulteti i Shkencave Humane;
 - d. Fakulteti i Shkencave të Edukimit;
 - e. Fakulteti Ekonomik.
5. UE ka në përbërje këto njësi bazë:
 - a) Departamenti i Matematikës
 - b) Departamenti i Informatikës
 - c) Departamenti i Biologjisë;
 - ç) Departamenti i Kimisë;
 - d) Departamenti i Fizikës;
 - dh) Qendra e Zhvillimit Mjedisor;
 - e) Departamenti i Infermieristikës;
 - f) Departamenti i Lëndëve Klinike;
 - g) Departamenti i Lëndëve Paraklinike;
 - gj) Departamenti i Specialiteteve Teknike Mjekësore¹;
 - h) Departamenti i Gjuhësisë;
 - i) Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë;
 - j) Departamenti i Histori-Gjeografisë;
 - k) Departamenti i Gjuhëve të Huaja²;
 - l) Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike;
 - ll) Departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies;

¹ Ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 6 datë 17.02.2022

² Ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 6 datë 17.02.2022



- m) Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar³
- n) Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve;
- nj) Departamenti i Psikologjisë;
- o) Qendra për Kërkimin dhe Zhvillimin në Edukim
- p) Departamenti i Administrim-Biznesit;
- q) Departamenti i Marketingut dhe Inxhinierisë;
- r) Departamenti i Financë-Kontabilitetit;
- rr) Departamenti i Ekonomiksit;
- s) Departamenti i së Drejtës;
- sh) Qendra Kërkimore Shkencore për Kërkime dhe Zhvillime në Drejtësi dhe Ekonomi⁴.

6. UE ka në përbërje këto njësi të tjera:

- a. Laboratori Eksperimental;
- b. Laboratori i Medias.

7. UE ka në përbërje këto struktura ndihmësakadematike me karakter administrativ në nivel institucioni:

- a. Drejtoria e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë.
Sektori i Koordinimit;
Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë.
LLL Centre Qendra për të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës⁵.
- b. Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë⁶.
Sektori i Kurrikulës dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;
Sektori i IT.
- c. Drejtoria Juridike, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI.
Sektori Juridik;
Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI.
- d. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës.
Sektori i Burimeve Njerëzore;
Sektori i Protokoll-Arkivës.
- e. Drejtoria e Bibliotekës.
Sektori i Klasifikimit;
Sektori i Arkivimit.

8. UE ka në përbërje këto struktura administrative në nivel institucioni:

- a. Bordi i Administrimit;
- b. Administratori i Institucionit
- c. Drejtorinë Ekonomike.
Sektori i Menaxhimit Buxhetor;
Sektori i Shërbimeve Financiare.
- d. Drejtorinë e Prokurimeve dhe Shërbimeve.
Sektori i Prokurimeve;
Sektori i Shërbimeve.
- e. Auditimi i Brendshëm.

³ Ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 6 datë 17.02.2022

⁴ Ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 6 datë 17.02.2022

⁵ Shtuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 6 datë 17.02.2022

⁶ Ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 6 datë 17.02.2022



9. UE ka në përbërje këto struktura akademike në nivel njësie kryesore:
- Asambleja e Personelit Akademik;
 - Dekanati;
 - Dekani;
 - Zëvendësdekani/ët
10. UE ka në përbërje këto struktura ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore:
- Specialist Protokoll Arkive⁷;
 - Kryesekretare;
 - Sekretare.
11. UE ka në përbërje këto struktura ndihmësakademike me karakter mësimor, në nivel njësie bazë:
- Laborantët
 - Specialistë Teknike⁸
12. UE ofron arsimim të lartë, zhvillim të dijeve, të shkencës, të inovacionit dhe të profesioneve.
13. UE zhvillon kërkim shkencor bazë e të zbatuar, veprimtari krijuese, ofron shërbime dhe ushtron veprimtari të tjera, në përputhje me fushat e programeve të studimit, me legjislacionin në fuqi, si dhe mbështet aftësimin e personelit akademik në funksion të misionit të tij.
14. UE ofron programe studimi në të gjitha ciklet e studimeve të arsimit të lartë, si dhe programe studimi me karakter profesional.

Neni 6

Organet dhe autoritetet drejtuese në UE

- Organi më i lartë drejtues akademik i UE-së është Senati Akademik. Organe të tjera akademike janë asambleja e personelit akademik dhe komisionet e përhershme.
- Autoritetet drejtuese akademike janë rektori, drejtuesi i njësisë kryesore, drejtuesi i njësisë bazë.
- Organi më i lartë drejtues administrativ është Bordi i Administrimit.
- Autoritetet drejtuese administrative janë: administratori i institucionit dhe administratori i njësisë kryesore. Autoritet administrativ është administratori i njësisë bazë.
- Organe kolegiale të tjera janë: rektorati, dekanati, këshilli i etikës.
- UE ka të drejtë të krijojë në strukturën e tij autoritete dhe organe të tjera, në përputhje me misionin, veprimtaritë e institucionit, sipas legjislacionit në fuqi.

⁷ Ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 6 datë 17.02.2022


⁸ Shtuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 6 datë 17.02.2022



Neni 7

Organigrama e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

(Ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 6 datë 17.02.2022)



KREU III
ORGANIZIMI AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E ELBASANIT
Organe dhe autoritete drejtuese

Neni 8
Senati Akademik

1. Senati është organi kolegjal më i lartë akademik i UE-së, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij.
2. Senati Akademik i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" përbëhet nga 23 (njëzet e tre) anëtarë. Njësitë kryesore përfaqësohen në Senat me nga 4 (katër) anëtarë.
3. Senati kryesohet nga rektori dhe mbledhet periodikisht.
4. Anëtarët e Senatit Akademik të UE-së zgjidhen nga asambljetë e personelit akademik të njësisë kryesore, përmes një votimi të përgjithshëm, për një mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar.
5. Anëtarët e senatit në institucionet e arsimit të lartë i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PhD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së, në mungesë të kandidaturave me këtë titull dhe për efekt të përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbrësë deri në gradën shkencore "Doktor" të fituar pranë universiteteve brenda vendit.
6. Në Senatit Akademik të UE-së përfaqësohen edhe studentët, në masën 10% (dhjetë përqind).
7. Mandati i anëtarit të Senatit ndërpritet kur:
 - jep dorëheqjen;
 - largohet nga UE;
 - bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrorë funksionin;
 - nuk merr pjesë për 3 (tri) herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme në mbledhjet e Senatit Akademik;
 - kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Vendi i mbetur vakant plotësohet nga kandidati pasardhës në renditje.

Neni 9
Funksionet e Senatit Akademik

Senati Akademik i UE-së ushtron këto funksione:

- a) garanton autonominë e UE-së, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve;
- b) i propozon Bordit të Administrimit planin strategjik të zhvillimit të institucionit;
- c) miraton statutin e UE-së me 2/3 e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit;
- ç) miraton rregulloren e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të tij;



- d) miraton rregulloret e institucionit, përveç atyre që janë kompetencë e Bordit të Administrimit;
- dh) miraton marrëveshjet apo memorandumet e bashkëpunimit;
- e) miraton strukturën e përgjithshme të institucionit të arsimit të lartë dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet;
- f) miraton procedurat për punësimin e personelit akademik dhe ndihmësakademik;
- g) i propozon Bordit të Administrimit buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit;
- gj) miraton programet e reja të studimit, të kërkimit shkencor, ndryshimet si dhe mbylljen e tyre. Programet e reja të studimit duhet të jenë të mbështetura në projektbuxhetin vjetor të institucionit;
- h) miraton numrin e studentëve për çdo program studimi;
- i) miraton kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi;
- j) propozon mbylljen dhe riorganizimin e institucionit, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- k) miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të institucionit mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë. Në këto raste merr vlerësimin paraprak të Bordit të Administrimit;
- l) miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore;
- ll) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit dhe ia përcjell atë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- m) zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Administrimit;
- n) miraton paraprakisht planin buxhetor vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit;
- nj) garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionin e arsimit të lartë;
- o) miraton mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik;
- p) krijon Komisionin e Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, për dhënien e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, kur institucioni plotëson kriteret ligjore, si edhe komisionet e tjera të përcaktuara në statut;
- q) organizon mbledhjen e përbashkët, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, në fund të çdo viti akademik, ku diskutohet për veprimtarinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe atë financiare;
- r) akordon tituj honorifikë sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Modalitetet e ushtrimit të këtij funksioni do të bëhen në akte të tjera të brendshme të UE-së.



Neni 10 **Rektori**

1. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i UE-së, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare.
2. Rektori zgjidhet nga anëtarët e asambleve të personelit akademik të njësive kryesore dhe studentët.
3. Rektori në institucionet e arsimit të lartë mban titullin “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose dhe jashtë tij.
4. Funkzioni i rektorit është i papajtuëshëm me funksionet e përgjegjësve të strukturave të UE-së, të kryetarit të komisionit të diplomës dhe të provimit të formimit.
5. Mandati i rektorit zgjat 4 (katër) vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit, ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.

Neni 11 **Funksionet e Rektorit**

Rektori ushtron këto funksione:

- a) drejton dhe kontrollon veprimtarinë e strukturave të UE-së për çështjet akademike dhe protokollare;
- b) përfaqëson UE-në në marrëdhënie me të tretët për çështjet akademike dhe protokollare;
- c) garanton zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, të statutit dhe të rregulloreve të UE-së;
- ç) paraqet propozimet për akte që janë në kompetencë për t’u shqyrtuar nga Senati Akademik dhe Këshilli i Etikës;
- d) nënshkruan në emër të UE-së marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata vendase apo të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë;
- dh) nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me karakter financiar, pas miratimit paraprak nga Bordi i Administrimit;
- e) cakton delegacionet dhe miraton planet e kualifikimit dhe të specializimit jashtë shtetit të stafit akademik dhe ndihmësakademik;
- ë) miraton kriteret e punësimit të personelit akademik (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme) si dhe të personelit ndihmësakademik me karakter mësimor sipas propozimeve të njësisë bazë;
- f) miraton kriteret e punësimit të personelit ndihmësakademik me karakter administrativ sipas propozimeve të njësisë kryesore;
- g) miraton kriteret e punësimit të personelit ndihmësakademik me karakter administrativ në nivel institucioni;
- gj) krijon komision *ad hoc* për konkursin e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë, sipas përcaktimeve në këtë statut;



- h) trajton ankesat lidhur me zhvillimin e konkursit për rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë, sipas afateve të përcaktuara në statut;
 - i) vendos ripërsëritjen e konkursit për rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë në rast konstatimi të parregullsive;
 - j) miraton klasifikimin përfundimtar të konkursit të punësimit të personelit akademik (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme) dhe emëron kandidatin/kandidatët e shpallur fitues;
 - k) miraton klasifikimin përfundimtar të konkursit për punësim të personelit ndihmësakademik dhe emëron kandidatin/kandidatët e shpallur fitues;
 - l) emëron dhe nënshkruan kontratat e punës me personelin akademik me kohë të plotë si dhe me personelin ndihmësakademik të UE-së;
 - ll) miraton dhënien e vitit akademik sabatik sipas përcaktimeve në këtë statut;
 - m) nënshkruan diploma dhe certifikata;
 - n) i propozon ministrin përgjegjës për arsimin shkarkimin e autoritetit drejtues të njësisë kryesore, në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së UE-së;
 - nj) ushtron të drejtën e dhënies së masave disiplinore ndaj personelit akademik dhe ndihmësakademik;
 - o) ushtron të drejtën e propozimit të dhënies së masave disiplinore ndaj personelit administrativ;
 - p) emëron dhe shkarkon zëvendësrektorin/ët, pas miratimit në Senatin Akademik;
 - q) përcakton fushën e veprimtimit të zëvendësrektorëve;
 - r) emëron drejtuesin e njësisë kryesore të shpallur fitues në zgjedhje;
 - rr) emëron drejtuesin e njësisë kryesore në rastet e krijimit të një njësie të re kryesore;
 - s) miraton propozimet e njësive bazë për punësimin e personelit akademik të ftuar;
- Rektori në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhëra, udhëzime dhe akte të tjera sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 12

Rektorati

1. Rektorati i UE-së është organ kolegjal që drejtohet nga rektori dhe përbëhet nga:
 - a) rektori;
 - b) zëvendësrektorët;
 - c) administratori i institucionit;
 - ç) drejtuesit e njësive kryesore.
2. Rektorati mblidhet në mënyrë periodike.
3. Mënyra e organizimit dhe funksionimit përcaktohen në rregulloren e UE-së.



Neni 13

Funksionet e Rektoratit

1.Rektorati ushtron këto funksione:

- a) harton projektplanin strategjik të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë;
- b) harton projektstatutin e UE-së dhe ia përcjell për miratim paraprak Bordit të Administrimit;
- c) harton projektregulloret e UE-së dhe ia përcjell për miratim Senatit Akademik;
- d) harton projektstrukturën e përgjithshme të UE-së dhe ia përcjell për miratim Senatit Akademik;
- e) harton projektplanin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore dhe ia përcjell për miratim Senatit Akademik;
- f) harton projektraportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit dhe ia përcjell për miratim Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit;
- g) harton projektplanin buxhetor vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe ia përcjell për miratim paraprak Senatit Akademik;
- h) harton mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe ia përcjell për miratim Senatit Akademik;
- i) merr vendim për pezullimin e studimeve, rifillimin e studimeve, transferimin e studimeve, mbi bazë të propozimeve të njëjësive bazë;
- j) monitoron njësitë e UE-së lidhur me: respektimin e procedurave për pranimet (regjistrimet) e reja, hartimin dhe zbatimin e strukturës së vitit akademik, zbatimin dhe realizimin e planeve dhe programeve mësimore, plotësimin e dokumentacionit që duhet të ketë çdo njësi kryesore dhe njësi bazë etj., për përmbushjen e qëllimeve të tij, si dhe për zbatimin e akteve të organeve dhe autoriteteve të UE-së;
- k) miraton modelin e kontratës së punës për punonjësit e UE-së;
- l) monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të UE- së;

Neni 14

Zëvendësrektorët

1. UE ka 2 (dy) zëvendësrektorë.
2. Zëvendësrektorët emërohen dhe shkarkohen nga rektori, pas miratimit në Senatin Akademik. Zëvendësrektorët i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PhD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Ai është anëtar i personelit akademik me kohë të plotë.
3. Funksionet dhe kompetencat e secilit zëvendësrektor përcaktohen me akt të rektorit.
4. Pas lirimit nga detyra ata vazhdojnë të jenë anëtarë të personelit të njëjësive bazë ku kryejnë veprimtarinë akademike.



Neni 15
Asambleja e personelit akademik

1. Asambleja e personelit akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore.
2. Asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore ka këto funksione:
 - a) zgjedh rektorin e universitetit;
 - b) zgjedh anëtarët e Senatit Akademik;
 - c) zgjedh drejtuesin e njësisë kryesore;
 - d) zgjedh anëtarët e komisioneve të përhershme të njësisë kryesore.

Neni 16
Drejtuesi i njësisë kryesore

1. Drejtuesi i njësisë kryesore është dekani i fakultetit. Ai është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj. Ai koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegjiale të njësisë kryesore si dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre.
2. Dekani zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore dhe studentët. Votat e studentëve në përzgjedhjen e drejtuesit llogariten në masën 10% (dhjetë përqind) të totalit të përgjithshëm të votave. Kandidati për drejtues vetëkandidohet. Ai është personel akademik i kategorisë “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose dhe jashtë tij.
3. Mandati i dekanit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.

Neni 17
Funksionet e drejtuesit të njësisë kryesore

1. Drejtuesi i njësisë kryesore ushtron këto funksione:
 - a) i përcjell Senatit Akademik propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij;
 - b) i përcjell rektorit propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij;
 - c) emëron drejtues të njësisë bazë kandidatin fitues në zgjedhje;
 - d) emëron drejtuesin e njësisë bazë në rastet e krijimit të një njësie bazë të re dhe ia përcjell rektorit;
 - e) emëron dhe shkarkon zëvendësdekanin;
 - f) i propozon rektorit shkarkimin e autoritetit drejtues të njësisë bazë në institucionet publike të arsimit të lartë në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e



parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit të arsimit të lartë. Rektori shprehet brenda një muaji. Zëvendësuesi i drejtuesit të njësisë bazë caktohet nga rektori, me propozimin e drejtuesit të njësisë kryesore;

- g) krijon komision *ad hoc* për konkursin e punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme bazuar në propozimin e drejtuesit të njësisë bazë;
 - h) trajton ankesat lidhur me zhvillimin e konkursit për rekrutimin e personelit akademik me kohë të pjesshme dhe i propozon rektorit miratimin e klasifikimit përfundimtar;
 - i) kryeson komisionin *ad hoc* për konkursin e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë në njësinë kryesore që drejton;
 - j) krijon komisionin, që do të realizojë procedurat për njohjen dhe njehsimin e periudhave të studimit për të gjitha rastet e përcaktuara në ligj dhe aktet e tjera nënligjore (rifillim studimesh, transferim studimesh etj.);
 - k) harton planin kalendarik;
 - l) i përcjell organeve dhe autoriteteve drejtuese të UE-së të gjitha aktet që dalin nga njësitë bazë dhe njësia kryesore që drejton, të shoqëruara me mendimet e tij;
 - m) miraton propozimin e njësisë bazë për përbërjen e komisioneve të provimeve të formimit, të mbrojtjes së diplomave dhe tezat e provimeve të formimit.
 - n) nënshkruan diplomat dhe certifikatat e përfundimit të studimeve
 - o) marrëdhëniet e drejtuesit të njësisë kryesore me organet e tjera, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij, parashikohen në rregulloren e UE-së;
2. Drejtuesi i njësisë kryesore në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhëra, udhëzime dhe akte të tjera sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 18 Dekanati

1. Dekanati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjal që drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga:
 - a) dekani;
 - b) zëvendësdekani/ët;
 - c) administratori i njësisë kryesore;
 - d) drejtuesit e njësive bazë.
2. Dekanati mblidhet në mënyrë periodike.
3. Mënyra e organizimit dhe funksionimit përcaktohet në rregulloren e UE-së.

Neni 19 Funksionet e Dekanatis

1. Dekanati ushtron këto funksione:
 - a) harton planin strategjik të zhvillimit të njësisë kryesore, mbështetur në propozimet e



- njësive bazë të tij;
- b) koordinon veprimtarinë e njësive bazë;
 - c) propozon hapjen e njësive bazë të reja;
 - d) miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore të njësisë kryesore, mbështetur në propozimet e njësive bazë të tij;
 - e) harton projektregulloret e njësisë kryesore dhe ia përcjell për miratim Senatit Akademik;
 - f) propozon strukturën e përgjithshme të njësisë kryesore dhe ia përcjell rektoratit;
 - g) propozon kritere për punësimin e personelit ndihmësakademik që janë në shërbim të njësisë kryesore dhe ia përcjell për miratim rektorit;
 - h) harton projektplanin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore të njësisë kryesore dhe ia përcjell rektoratit;
 - i) harton projektraportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së njësisë kryesore dhe ia përcjell rektoratit;
 - j) monitoron njësitë bazë të njësisë kryesore lidhur me respektimin e procedurave për pranimet (regjistrimet) e reja, hartimin dhe zbatimin e strukturës së vitit akademik, zbatimin dhe realizimin e planeve dhe programeve mësimore, plotësimin e dokumentacionit që duhet të ketë çdo njësi kryesore dhe njësi bazë, etj., për përmbushjen e qëllimeve të tij, si dhe për zbatimin e akteve të organeve dhe autoriteteve të UE-së;
 - k) përcjell në rektorat propozimin e njësisë bazë për pezullimin e studimeve, rifillimin e studimeve, transferimin e studimeve, mbi bazë të propozimeve të njësive bazë, shoqëruar me mendimet e veta;
 - l) miraton dhe shpall listën e studentëve përsëritës në fund të çdo viti akademik, sipas përcaktimeve në rregulloren e UE-së.

Neni 20

Zëvendësdekani

1. Zëvendësdekani emërohet dhe shkarkohet nga dekani. Ai është anëtar me kohë të plotë i personelit akademik të njësisë kryesore dhe duhet të ketë të paktën gradën shkencore "Doktor".
2. Funkcionet dhe kompetencat e zëvendësdekanit përcaktohen me akt të dekanit, sipas përcaktimeve në rregulloren e UE-së.
3. Pas lirimit nga detyra zëvendësdekani vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë akademike.

Neni 21

Drejtuesi i njësisë bazë

1. Drejtuesi i njësisë bazë është drejtuesi i departamentit ose i qendrës kërkimore-shkencore. Ai



- është autoriteti drejtues akademik i asaj njësie dhe e përfaqëson atë.
2. Drejtuesi i njësisë bazë zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë bazë. Ai zgjidhet ose emërohet sipas përcaktimeve në ligj dhe statutin e institucionit.
 3. Drejtuesi i njësisë kryesore emëron drejtues të njësisë bazë kandidatit fitues të zgjedhjeve. Në rastet e krijimit të një njësie të re bazë në UE, drejtuesi i saj emërohet nga dekani për një mandat me kohëzgjatje deri në zhvillimin e zgjedhjeve të drejtuesit të njësisë bazë.
 4. Kandidati për drejtues vetëkandidohet dhe është personel akademik i kategorisë “Profesor” ose ka gradën shkencore “Doktor” (“PhD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, kur ky i fundit mban gradën shkencore “Doktor”.
 5. Drejtuesi mund të shërbejë në detyrë për një mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.

Neni 22

Funksionet e drejtuesit të njësisë bazë

1. Drejtuesi i njësisë bazë ushtron këto funksione:
 - a) i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore propozimin e njësisë për programet e reja të studimit;
 - b) i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore propozimin e njësisë për kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, që ofron njësia bazë;
 - c) i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore propozimin e njësisë për numrin e studentëve për çdo program studimi që ofron njësia bazë;
 - d) i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore propozimin e njësisë bazë për kriteret e rekrutimit për personelin akademik dhe të personelit ndihmësakademik që ka në shërbim;
 - e) i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore propozimin e njësisë bazë për miratimin e dhënies së vitit akademik sabbatik të kërkuar nga personeli akademik i njësisë bazë, që i përket kategorisë “Lektor” dhe “Profesor”;
 - f) i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore propozimin e njësisë bazë për personelin akademik të ftuar që do të kërkohet të punësohet me kontratë për periudha të shkurtra kohore;
 - g) krijon dhe drejton komisionin përgjegjës për procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për studentë fitues dhe miraton listën e fituesve;
 - h) përcakton ngarkesën mësimore për personelin akademik të njësisë bazë, pasi ka marrë mendimin e anëtarëve të njësisë bazë dhe ia përcjell drejtuesit të njësisë kryesore për miratim, duke zbatuar kriteret e mëposhtme:
 - i. titulli/grada që përfaqëson kualifikimin kërkimor shkencor në përputhje me fushën e grupdisiplinave përkatëse;
 - ii. eksperiencia në mësimdhënie në fushën përkatëse;



- iii. vjetërsia në punë;
 - iv. trajtimi i barabartë me ngarkesë mësimore i personelit akademik.
 - v. diskutimi i leksioneve dhe kërkimeve shkencore në njësinë bazë.
- i) i propozon drejtuesit të njësisë kryesore përbërjen e komisioneve të provimeve të formimit, të mbrojtjes së diplomave dhe tezave të provimeve të formimit;
 - j) përcakton përfaqësuesit e njësisë bazë anëtarë në komisionin *ad hoc* për konkursin e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme për njësinë bazë dhe ia përcjell për miratim drejtuesit të njësisë kryesore;
 - k) përcakton përfaqësuesit e njësisë bazë anëtarë në komisionin *ad hoc* për konkursin e rekrutimit të personelit ndihmësakademik, në shërbim të njësisë bazë dhe ia përcjell për miratim drejtuesit të njësisë kryesore;
 - l) miraton paraprakisht kërkesën e personelit akademik me kohë të plotë të njësisë bazë, për t'u angazhuar me kohë të pjesshme në një institucion tjetër të arsimit të lartë;
 - m) harton planin strategjik të zhvillimit të njësisë bazë;
2. Drejtuesi i njësisë bazë në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhëra, udhëzime dhe akte të tjera siaps legjislacionit në fuqi.

Organe të tjera kolegjiale të përhershme

Neni 23

Këshilli i Etikës i UE-së

1. Këshilli i Etikës i UE-së, është organ kolegjial vendimmarrës, i cili promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, cënimin e integritetit dhe interesave institucionale, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale.
2. Këshilli i Etikës shqyrton dhe merr vendim në lidhje me veprimtari të personelit akademik dhe atij ndihmësakademik nëse përbëjnë shkelje të etikës ose jo.
3. Këshilli i Etikës përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë. Këshilli kryesohet nga zëvendësrektori. 5 (pesë) anëtarë janë përfaqësues nga secila njësi kryesore, të cilët vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik me shumicë të thjeshtë votash. Njëri prej anëtarëve është personel akademik me formim jurist i cili propozohet nga rektori dhe miratohet nga Senati Akademik.
4. Këshilli i Etikës vihet në lëvizje me kërkesë të autoriteteve drejtuese në UE, apo çdo personi të interesuar që ka lidhje me veprimtarinë institucionale.
5. Në rastet kur Këshilli i Etikës do të konstatojë shkelje të etikës në institucion dhe ndaj institucionit, vendimi përkatës do të përbëjë shkak për marrjen e masave disiplinore.
6. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Etikës së UE-së përcaktohen në rregulloren përkatëse.



Neni 24 Komisionet e përhershme

1. Komisionet e përhershme janë organe kolegjiale, që kryejnë funksione në fushat që lidhen me:
 - a) kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik;
 - b) garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit;
 - c) marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikat e institucionit.
2. Komisionet e përhershme në UE organizohen në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore.
3. Komisione të përhershme në nivel institucional në UE janë:
 - a) Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit. Ky komision përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, nga të cilët 6 (gjashtë) janë anëtarë nga personeli akademik i UE-së që i përkasin kategorisë “Profesor” ose/dhe “Lektor” dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.
 - b) Komisioni për marrëdhëniet me studentët dhe këshillimin e karrierës. Ky komision përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, nga të cilët, 6 (gjashtë) janë anëtarë nga personeli akademik i UE-së që i përkasin kategorisë “Profesor” ose/dhe “Lektor” dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.
 - c) Komisioni për promovimin e personelit akademik. Ky komision përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë personel akademik i UE-së, që mbajnë titullin “Profesor”.

Anëtarët e komisioneve të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
4. Komisione të përhershëm në nivel njësie kryesore në UE janë:
 - a) Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë së njësisë kryesore dhe programeve të studimit.
Ky komision përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët, 4 (katër) janë anëtarë nga personeli akademik i njësisë kryesore që i përkasin kategorisë “Profesor” ose/dhe “Lektor” dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.
 - b) Komisioni i monitorimit të dhënies së gradës shkencore “Doktor”.
Ky komisionet përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë nga personeli akademik i njësisë kryesore që i përkasin kategorisë “Profesor”.
 - c) Komisioni për mbrojtjen e studentëve.
Ky komision përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët, 4 (katër) janë anëtarë nga personeli akademik i njësisë kryesore, që i përkasin kategorisë “Profesor” ose/dhe “Lektor” dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.

Anëtarët e komisioneve të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni vetëkandidohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore midis anëtarëve të saj, për një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.



5. Komisionet e përhershme gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre marrin vendime me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tyre.
6. Anëtarët e komisioneve të përhershme mund të shpërblehen për punën e tyre sipas përcaktimeve në aktet nënligjore.
7. Mënyra e funksionimit përcaktohet në rregulloren e UE-së.



KREU IV
ORGANIZIMI ADMINISTRATIV I UE-së
Organe dhe autoritete drejtuese administrative të UE-së

Neni 25
Bordi i Administrimit i UE-së

1. Bordi i Administrimit i UE-së është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.
2. Ai përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë të punësuar me kohë të pjesshme. 4 (katër) anëtarë janë të emëruar nga ministria përgjegjëse për arsimin, ndërsa 3 (tre) prej tyre janë anëtarë të personelit akademik të UE-së për një mandat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Rektori, drejtuesit e njësive kryesore, drejtuesit e njësive bazë dhe administratorët nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të Administrimit të UE-së, por mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e tij.
4. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të Bordit të Administrimit të UE-së përcaktohet në rregulloren e UE-së.

Neni 26
Funksionet e Bordit të Administrimit në UE

1. Bordi i Administrimit i UE-së ka këto funksione kryesore:
 - a) garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
 - b) me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
 - c) me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
 - d) me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;
 - e) vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
 - f) miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;
 - g) jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
 - h) përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
 - i) është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe



- personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;
- j) është përgjegjës për dhënien e masave disiplinore për personelin administrativ;
 - k) emëron administratorin e UE-së;
 - l) shkarkon administratorin e UE-së me 2/3 e votave të anëtarëve të tij;
 - m) miraton paraprakisht statutin e UE-së, para se t'i përcillet Senatit Akademik;
 - n) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.
2. Vendimi i Bordit të Administrimit të UE-së, për përcaktimin e bërë në shkronjën "m", të pikës 1, të këtij neni, merret me jo më pak se 3/5 e votave të anëtarëve.
 3. Rregullat e organizimit dhe funksionimit të Bordit të Administrimit të UE-së përcaktohen në rregulloren e UE-së .

Neni 27

Administratori i UE-së

1. Administratori i UE-së është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative.
2. Ai përzgjidhet me konkurs të hapur, sipas kriterëve të përcaktuara nga Bordi i Administrimit. Lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret miratohet nga Senati Akademik. Emërimi i administratorit bëhet nga Bordi i Administrimit.
3. Administratori i UE-së shkarkohet nga Bordi i Administrimit me 2/3 e votave të anëtarëve të tij.
4. Administratori i UE-së duhet të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin "Master i shkencave" në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune së paku shtatë vjet në këto fusha.

Neni 28

Funksionet e Administratorit të UE-së

Administratori kryen këto funksione:

- a) harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësisve kryesore dhe të njësisve bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij;
- b) propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare e materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit dhe mbikëqyr shpërndarjen e zbatimin e tyre;
- c) ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të institucionit të arsimit të lartë në strukturat e varësisë së tij;
- d) zbaton të gjitha vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik me karakter financiar dhe administrativ;
- e) i paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik raportin mbi veprimtarinë financiare të institucionit të arsimit të lartë, në përfundim të vitit akademik;



- f) bashkëpunon me strukturat dhe autoritetet e tjera të institucionit të arsimit të lartë për çështje të administrimit të përditshëm;
- g) i propozon Bordit të Administrimit kriteret specifike të punësimit të personelit administrativ si dhe marrjen e masave disiplinore;
- h) krijon komision *ad hoc* për konkursin e rekrutimit të personelit administrativ, sipas përcaktimeve në këtë statut;
- i) trajton ankesat lidhur me zhvillimin e konkursit për rekrutimin e personelit administrativ, sipas afateve të përcaktuara në statut;
- j) vendos ripërsëritjen e konkursit për rekrutimin e personelit administrativ në rast konstatimi të parregullsive;
- k) miraton klasifikimin përfundimtar të konkursit të rekrutimit të personelit administrativ dhe emëron kandidatin e shpallur fitues;
- l) harton dhe nënshkruan kontratën e punës me personelin administrativ të UE-së;
- m) emëron dhe shkarkon administratorët e njësisë kryesore dhe njësisë bazë pas miratimit të Bordit të Administrimit;
- n) plotëson kërkesat e rektorit, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare.

Neni 29

Mbarimi i parakohshëm i mandatit të autoriteteve drejtuese dhe anëtarëve të zgjedhur të organeve drejtuese të institucionit publik të arsimit të lartë

1. Mandati i autoritetit ose i anëtarit të zgjedhur mbaron para kohe në rastet:
 - a) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - b) kur anëtari i organit ose autoriteti jep dorëheqjen;
 - c) e pamundësisë për të kryer detyrën;
 - d) e shkeljeve të rënda të ligjit;
 - e) e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës si punonjës i UE-së;
 - f) e ndryshimit të raporteve të përfaqësimit në organin drejtues.
2. Shkarkimi i anëtarëve të Bordit të Administrimit bëhet nga ministri përgjegjës për arsimin, me propozimin e organit që i zgjedh apo emëron.
3. Shkarkimi për secilin autoritet apo anëtar të organeve drejtuese bëhet nga i njëjti organ që i ka zgjedhur, në momentin e plotësimit të vendit vakant.
4. Në rast mbarimi të parakohshëm të mandatit të autoriteteve dhe anëtarëve të zgjedhur të organeve, mandati i anëtarit të ri të zgjedhur të organit drejtues është plotësues.



KREU V
PERSONELI I UE-së

Neni 30
Personeli i UE-së

1. Personeli i UE-së përbëhet nga:
 - Personel akademik;
 - Personel ndihmësakademik;
 - Personel administrativ.

Neni 31
Kategoritë e personelit akademik të UE-së

1. Personeli akademik në UE kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të institucionit të arsimit të lartë, këshillim për studentët si dhe veprimtari të tjera.
2. Personeli akademik mund të jetë me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor. Personeli akademik në institucionet e arsimit të lartë, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:
 - a) profesorë;
 - b) lektorë;
 - c) asistent-lektorë.
3. Në kategorinë “Profesorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë “Profesor” ose “Profesor i asociuar”. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar sipas përcaktimeve në strukturën organizative të UE-së.
4. Në kategorinë “Lektorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik që mbajnë gradën shkencore “Doktor”, kanë së paku 3 (tre) vite eksperiencë në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.
5. Në kategorinë “Asistent-lektorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Asistent-lektorët duhet të kenë së paku diplomën “Master i shkencave”. Si kriter përzgjedhës për këtë kategori duhet të jetë përputhshmëria e fushës ku ka kryer studimet dhe vendit të punës për të cilin konkurron.
6. Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.
7. Raportet ndërmjet veprimtarive të ndryshme për personelin akademik, të përcaktuara në



pikën 1, të këtij neni, përcaktohen nga institucioni i arsimit të lartë.

8. Ngarkesa e plotë mësimore për personelin akademik në institucionet publike të arsimit të lartë përcaktohet nga institucioni, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.

Neni 32 **Titujt akademikë**

1. Titujt akademikë “Profesor” dhe “Profesor i asociuar” jepen nga institucionet e arsimit të lartë, të llojit “universitet”, të cilët:
 - a) ushtrojnë veprimtari akademike dhe kërkimore-shkencore, në mënyrë të vazhdueshme, për jo më pak se dhjetë vjet;
 - b) janë institucione të akredituara;
 - c) kanë të punësuar si personel akademik jo më pak se 18 (tetëmbëdhjetë) anëtarë të personelit akademik që mbajnë titullin “Profesor”, me kohë të plotë, me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar. Në çdo rast, universiteti duhet të ketë të paktën 5 (pesë) pedagogë me kohë të plotë që mbajnë titullin “Profesor” në çdo njësi kryesore;
 - d) ofrojnë studimet e doktoratës apo specializime afatgjata;
 - e) përmbushin kritere të tjera shtesë, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Standardet shtetërore për fitimin e titujve “Profesor” dhe “Profesor i asociuar” përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 33 **Fitimi i titujve akademikë**

1. Për fitimin e titullit “Profesor i asociuar” mund të aplikojë personeli akademik që gëzon gradën shkencore “Doktor”, prej së paku 5 (pesë) vitesh, është personel akademik i kategorisë “Lektor” dhe përmbush standardet shtetërore për fitimin e titullit. Për fitimin e titullit “Profesor” mund të aplikojë personeli akademik që gëzon prej së paku 5 (pesë) vitesh titullin “Profesor i asociuar”, si dhe përmbush standardet shtetërore për fitimin e titullit.
2. Personeli akademik i institucioneve të arsimit të lartë, të cilat nuk përmbushin kriteret për dhënien e titujve akademikë, si dhe personat, të cilët nuk janë personel akademik pranë ndonjë institucioni, por përmbushin standardet për fitimin e titujve, paraqesin kërkesën pranë një institucioni, i cili përmbush kriteret për dhënien e titujve.
3. Kandidati për fitimin e titullit “Profesor i asociuar” ose “Profesor” paraqet dosjen pranë drejtuesit të njësisë kryesore. Dosja e kandidatit i përcillet Senatit Akademik, pas paraqitjes dhe vlerësimit në njësinë bazë. Senati i kalon dosjen Komisionit të Përherëshëm për Promovimin e Personelit Akademik, i cili merr vendimin përfundimtar pas vendimit të jurisë mbi përmbushjen e standardeve. Titulli regjistrohët në regjistrin shtetëror të gradave



shkencore dhe titujve akademikë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin. Titulli akademik lëshohet nga institucioni dhe nënshkruhet nga rektori.

4. Në rast vlerësimi negativ të kërkesës për fitimin e titujve akademikë nga Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, kandidatit i lind e drejta të ripërsërisë kërkesën pas një periudhe kohore jo më të shkurtër se 2 (dy) vjet.
5. Personelit akademik, që mban titullin “Profesor”, pas daljes në pension, në vlerësim të veprimitarisë së spikatur akademike, me propozim të njësisë bazë ku ka zhvilluar karrierën e tij dhe me vendim të Senatit Akademik, i akordohet titulli “Profesor emeritus”.

Neni 34

Personeli akademik i ftuar

1. Njësitë bazë të UE-së kanë të drejtë të kërkojnë të punësojnë me kontratë për periudha të shkurtra kohe, studiues, personalitete, artistë vendas ose të huaj.
2. Propozimet e njësisë bazë për punësimin e personelit akademik të ftuar, miratohen nga rektori.
3. Për përzgjedhjen e personelit akademik të ftuar ndërthuren kualifikimet e tyre me nevojën e njësisë bazë për veprimtari mësimdhënieje ose kërkimore-shkencore.
4. Shpenzimet për personelin akademik të ftuar përballohen nga të ardhurat e institucionit.

Neni 35

Viti akademik sabatik

1. Personeli akademik i kategorisë “Lektor” dhe “Profesor”, me miratim të njësisë bazë ku zhvillon veprimtarinë akademike, ka të drejtë të shkëputet nga angazhimet e institucionit, një herë në 7 (shtatë) vjet, për periudha kohe deri në 1 (një) vit, për të punuar për përparimin e tij akademik.
2. Për periudhën e vitit akademik sabatik të miratuar, personeli akademik gëzon të drejtën e pagës sipas akteve nënligjore në fuqi.
3. Marrëdhëniet juridike ndërmjet palëve për këtë periudhë rregullohen në kontratën midis rektorit dhe personelit akademik.
4. Nuk ka të drejtë të shkëputet për vitin sabatik personeli akademik që ka më pak se 7 (shtatë) vjet punë në UE.

Neni 36

Personeli ndihmësakademik

1. Personeli ndihmësakademik ndahet në personel ndihmësakademik me karakter mësimor dhe ndihmësakademik me karakter administrativ.
2. Personeli ndihmësakademik me karakter mësimor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor. Ai është pjesë e njësisë bazë dhe



shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Në këtë kategori futen laborantët dhe teknikët, si dhe personel tjetër, sipas përcaktimeve të bëra në aktet e brendshme të institucionit.

3. Personeli ndihmësakademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të UE-së në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional. Në këtë kategori bëjnë pjesë personeli i përcaktuar në rregulloren e brendshme të UE-së.
4. Kriteret e punësimit të personelit ndihmësakademik, propozohen nga njësia së cilës ky personel i shërben, bazuar në nevojat e kësaj të fundit. Konkursi i rekrutimit drejtohet nga një komision *ad hoc*, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë përkatëse.
5. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit *ad hoc*, si edhe të përzgjedhjes së personelit ndihmësakademik përcaktohen në rregulloren e UE-së.

Neni 37

Personeli administrativ

1. Personeli administrativ i UE-së ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive financiare dhe administrative në institucion.
2. Kategoritë e personelit administrativ dhe nivelet e pagave miratohen nga Bordi i Administrimit të UE-së, sipas legjislacionit në fuqi.



KREU VI PUNËSIMI NË UE

Neni 38 Punësimi i personelit akademik

1. Punësimi i personelit akademik në UE bëhet me konkurs.
2. Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme përcaktohen nga njësi bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit dhe miratohen nga rektori.
3. Rektori krijon komisionin *ad hoc* për rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë.
4. Komisioni *ad hoc* vlerëson dhe rendit kandidatët konkurrues sipas pikëzimit të vendosur në rregulloren e UE-së.
5. Komisioni *ad hoc* propozon renditjen përfundimtare për miratim nga rektori.
6. Ankesat në lidhje me vlerësimin e kandidatëve dhe zbatimin e procedurave nga komisioni *ad hoc*, paraqiten brenda 10 (dhjetë) ditëve te rektori. Në rast të konstatimit të parregullsive në zbatimin e procedurave, rektori vendos për pavlefshmërinë e procesit dhe ripërsëritjen e tij.
7. Rektori miraton klasifikimin përfundimtar dhe shpall fituesin e procedurës.
8. Rektori emëron kandidatin fitues dhe nënshkruan kontratën e punës.
9. Modalitetet e tjera të punësimit përcaktohen në rregulloren e UE-së.

Neni 39 Punësimi i personelit ndihmësakademik

1. Punësimi i personelit ndihmësakademik në UE bëhet me konkurs publik.
2. Punësimi do të realizohet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në rregulloren e UE-së.
3. Komisioni *ad hoc* vlerëson dhe rendit kandidatët konkurrues sipas pikëzimit të vendosur në rregulloren e UE-së.
4. Komisioni *ad hoc* i propozon për miratim rektorit renditjen përfundimtare.
5. Ankesat në lidhje me vlerësimin e kandidatëve dhe zbatimin e procedurave nga komisioni *ad hoc*, paraqiten brenda 10 (dhjetë) ditëve te rektori. Në rast të konstatimit të parregullsive në zbatimin e procedurave, rektori vendos për pavlefshmërinë e procesit dhe ripërsëritjen e tij.
6. Rektori miraton klasifikimin përfundimtar dhe shpall fituesin e procedurës.
7. Rektori emëron kandidatin fitues dhe nënshkruan kontratën e punës.
8. Modalitetet e tjera të punësimit përcaktohen në rregulloren e UE-së.



Neni 40

Punësimi i personelit administrativ

1. Punësimi i personelit administrativ në UE bëhet me konkurs publik.
2. Punësimi do të realizohet sipas kriterëve dhe procedurave të propozuara nga administratori dhe të miratuara nga Bordi i Administrimit të UE-së.
3. Në përfundim të procedurave të rekrutimit, kontrata e punësimit do të nënshkruhet nga administratori i institucionit.

Neni 41

Përgjegjësia për masat disiplinore për personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ

1. Personeli i UE-së është përgjegjës për shkeljen e detyrimeve të parashikuara nga aktet ligjore, nënligjore dhe aktet e brendshme të UE-së.
2. Shkeljet ndahen në:
 - a) shkelje të rënda;
 - b) shkelje të lehta.
3. Janë shkelje të rënda:
 - a) mospërbushja e detyrave;
 - b) shkelje në mënyrë të përsëritur e etikës në UE;
 - c) sjellja e parregullt, në mënyrë të përsëritur, gjatë kohës së punës me eprorët, kolegët, vartësit dhe me studentët;
 - d) dëmtimi i pronës shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pronës shtetërore;
 - e) kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, e veprimeve apo qëndrimeve që çënojnë figurën e personelit akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe institucionit në tërësi;
 - f) shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit apo të dhënave që gjenerojnë nga veprimtaria e UE-së dhe që nuk janë objekt i së drejtës së informimit;
 - g) shpërndarja dhe keqpërdorimi i informacionit apo të dhënave që gjenerojnë nga veprimtaria e UE-së dhe që nuk janë objekt i së drejtës së informimit.
4. Janë shkelje të lehta:
 - a) shkelja e rregullave të etikës;
 - b) sjellja e parregullt gjatë kohës së punës, me eprorët, kolegët, vartësit dhe me studentët;
 - c) kryerja, brenda ose jashtë orarit zyrtar, e veprimeve apo qëndrimeve që çënojnë figurën e personelit akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe institucionit në tërësi.



Neni 42
Lloji i masave disiplinore

1. Masat disiplinore për personelin akademik dhe ndihmësakademik të UE-së janë:
 - a) vërejtje;
 - b) vërejtje me shkrim;
 - c) vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra;
 - d) pezullim nga detyra, deri në marrjen e vendimit të formës së prerë, për çështje administrative apo penale;
 - e) largim nga puna.
2. Largimi nga detyra i personelit akademik të UE-së bëhet nga rektori, me propozimin e drejtuesit të njësisë bazë, ku personeli akademik zhvillon veprimtarinë e tij dhe pas miratimit të komisionit *ad hoc*, të ngritur nga Senati Akademik, në rastet e shkeljeve të rënda dhe të përsëritura të ligjit.
3. Largimi nga detyra i personelit ndihmësakademik të UE-së bëhet nga rektori, sipas përcaktimeve të Kodit të Punës.

Neni 43
Masat disiplinore për personelin administrativ

1. Masat disiplinore për personelin administrativ të UE-së janë:
 - a) vërejtje;
 - b) vërejtje me shkrim;
 - c) vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra;
 - d) pezullim nga detyra, deri në marrjen e vendimit të formës së prerë, për çështje administrative apo penale;
 - e) largim nga puna.
2. Masat disiplinore të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, propozohen nga administratori dhe miratohen nga Bordi i Administrimit.

Neni 44
Parashkrimi i masave disiplinore

1. Masa disiplinore “vërejtje” dhe “vërejtje me shkrim” si rregull mund të jepet për shkelje të lehta dhe regjistrohet në dosjen e personelit. Kjo masë konsiderohet si e pa dhënë dhe hiqet nga dosja e personelit me kalimin e një afati 6 (gjashtë) mujor, nëse gjatë kësaj kohe personeli nuk merr një masë tjetër të njëjtë ose më të rëndë disiplinore.
2. Masa “vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra” si rregull mund të jepet për shkelje të lehta dhe të përsëritura. Kjo masë disiplinore regjistrohet në dosjen e personelit dhe i ruan efektet për një periudhë 1 (një) vjeçare.



Neni 45
Përfundimi i marrëdhënieve të punës

1. Marrëdhënia e punës së personelit të UE-së përfundon edhe në rastet kur:
 - a) jep dorëheqjen;
 - b) mbush moshën e pensionit;
 - c) kur ndaj tij janë dhënë dy masa disiplinore të njëpasnjëshme vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra;
 - d) kur është dhënë masa disiplinore e largimit nga detyra;
 - e) për rastet e parashikuara në Kodin e Punës për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës.



KREU VII
PROGRAMET E STUDIMIT DHE ORGANIZIMI I TYRE

Neni 46

Format e studimeve dhe pranimi i studentëve

1. Forma e studimeve në UE është:
 - a. Studime me kohë të plotë.
2. Studimet me kohë të zgjatur mund të ofrohen në:
 - a. Programet e studimit 1 (një) deri në 2 (dy) vjeçare me karakter profesional;
 - b. Programet e ciklit të dytë "Master profesional".
3. Programet e studimit, që japin të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, organizohen vetëm në formën e studimeve me kohë të plotë.
4. Pranimi dhe regjistrimi i studentëve në UE bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 47

Ciklet dhe programet e studimeve

1. Programet e studimeve organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS).
2. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 (gjashtëdhjetë) kredite.
3. Programet e studimeve në UE hartohen nga njësitë bazë dhe i paraqiten për miratim Senatit Akademik.
4. Programet e studimeve në UE janë të organizuara në 3 (tre) cikle të njëpasnjëshme:
 - a. cikli i parë;
 - b. cikli i dytë;
 - c. cikli i tretë;

Në përfundim të programeve lëshohet diploma përkatëse në fushën e arsimimit të kryer.

5. UE ofron edhe diploma profesionale, referuar nivelit 5 (pesë) të Komizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të programit lëshohet "Diplomë profesionale" në fushën e arsimimit të kryer.

Neni 48

Programet e ciklit të parë të studimeve

1. Programet e ciklit të parë të studimit, organizohen me 180 (njëqind e tetëdhjetë) kredite evropiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tre) vite akademike.



2. Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome.
3. Në rregulloren e studimeve të UE-së përcaktohet pragu i notës mesatare, që i jep të drejtë studentit të ciklit të parë të diplomohet, duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome.
4. Në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diploma “Bachelor” në fushën e arsimimit të kryer.

Neni 49

Pranimi në ciklin e parë të studimeve

1. Pranimi i studentëve në programet e studimit të ciklit të parë në UE është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson:
 - a. Kriterin e notës mesatare e përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave;
 - b. Kriterin e rëndësisë (koeficienti i përcaktuar për shkollën nga vjen, sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në UE) sipas përcaktimeve të njësive bazë;
 - c. Kuotat e miratuara;
 - d. Lëndët me zgjedhje.

Neni 50

Programet e ciklit të dytë të studimeve

Cikli i dytë i studimeve në UE përfshin programet e studimit “Master i shkencave” dhe “Master profesional”.

1. Programet e studimit “Master i shkencave” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësi për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Këto programe:
 - a) Organizohen me jo më pak se 120 (njëqind e njëzet) kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike;
 - b) Studimet e ciklit të dytë “Master i shkencave” përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i shkencave” në fushën e arsimimit të kryer.
2. Programet e studimeve “Master profesional” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar. Këto programe:
 - a) Organizohen me 60 (gjashtëdhjetë) ose 120 (njëqind e njëzet) kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1 (një) vit ose 2 (dy) vite akademike.
 - b) Studimet e ciklit të dytë “Master profesional” përmbyllen me provim përfundimtar formimi ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master profesional” në fushën e arsimimit të kryer.
3. Në rregulloren e studimeve të UE-së përcaktohet pragu i notës mesatare, që i jep të drejtë studentit të ciklit të dytë të diplomohet, duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome.



Neni 51

Pranimi në ciklin e dytë të studimeve

1. Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara nga Senati Akademik i UE-së.
2. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë "Master i shkencave" është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit European: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.

Neni 52

Programet e ciklit të tretë të studimeve

1. Cikli i tretë i studimeve përfshin programin e:
 - a) Studimeve të doktoratës.
2. Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësitë bazë ose njësitë kryesore. Këto programe:
 - a) kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese;
 - b) zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike;
 - c) në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore "Doktor";
3. Elemente të tjera specifike përcaktohen në rregulloren e doktoratës.

Neni 53

Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve

1. Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë fituar diplomën "Master i shkencave".
2. Kriteret e pranimit në programet e ciklit të tretë përcaktohen nga njësitë bazë. Këto kritere duhet të jenë në përputhje me Standardet Shtetërore të Cilësisë dhe të pasqyruara në rregulloren e doktoraturës.
3. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të tretë është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit European: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare.



- a) Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- 4. Lista e studentëve fitues dërgohet te Qendra e Shërbimeve Arsimore, sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- 5. Lista e të diplomuarve në programet e ciklit të tretë i përcillet ministrisë përgjegjëse për arsimin, për t'u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë.

Neni 54

Zhvillimi i studimeve të doktoratës

1. Studimet e doktoratës zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
2. Për të mundësuar zhvillimin e studimeve të doktoratës, UE, njësitë bazë dhe njësitë kryesore, hartojnë projekte kërkimore shkencore dhe zhvillimi për këto studime. Ato aplikojnë për financim pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit apo institucioneve të tjera financuese.
3. Kur studimet e doktoratës zhvillohen në bashkëpunim midis institucioneve të arsimit të lartë, pjesë të procesit kërkimor, mund të zhvillohen pranë institucioneve bashkëpunuese.
4. Punimet në doktoraturë mund të udhëhiqen nga 2 (dy) tutorë kur ekziston mundësia e një partneriteti midis UE-së dhe një institucioni tjetër të arsimit të lartë, ku njëri prej tutorëve të jetë punonjës akademik i UE-së.
5. Numri i studentëve doktorantë përcaktohet nga njësia bazë.
6. Projekti kërkimor i çdo doktoranti përcaktohet në varësi të projekteve kërkimore dhe prioriteteve të njësisë bazë.
7. Për kryerjen e studimeve të doktoratës, studenti mund të përfitojë edhe financime nga subjekte të tjera apo të vetëfinancohet.
8. Drejtuesit shkencorë të doktorantëve duhet:
 - a) Të kenë titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar”;
 - b) Numri i studentëve për udhëheqje, përcaktohet sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 55

Programet e përbashkëta të studimit

1. UE është i hapur për të realizuar programe të përbashkëta studimi në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose jopublike, brenda ose jashtë vendit.
2. Procesi i realizimit të programeve të përbashkëta realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me marrëveshjen përkatëse të bashkëpunimit.



3. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë ose e shumëfishtë nga institucionet pjesëmarrëse.

Neni 56

Programet e studimit në fushën e mësuesisë

1. Programet e studimit në fushën e mësuesisë për arsim parashkollor dhe arsim fillor, organizohen në dy cikle:
 - a) program i ciklit të parë "Bachelor", që formon mësues të arsimit parashkollor;
 - b) program i ciklit të dytë "Master profesional", që formon mësues të arsimit fillor.
2. Programet e studimit për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", me 120 (njëqind e njëzet) kredite, sipas fushave përkatëse të formimit.
3. Programet e ciklit të dytë të studimit në fushën e mësuesisë duhet të përmbajnë 25% (njëzet e pesë përqind) të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik.
4. Programet e ciklit të dytë të studimit, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80% (tetëdhjetë përqind) të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.

Neni 57

Ndjekja e një programi të dytë studimi

1. Personat që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi të të njëjtit cikël. Në këtë rast përzgjidhen ata me mesatare më të lartë.
2. Personat përballojnë koston e plotë të studimeve. Përjashtohen nga ky rregull studentët e shkëlqyer.
3. Për t'u pranuar në një program të dytë studimi, kandidati duhet të plotësojë kriterin e notës mesatare sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 58

Transferimi i studimeve

1. UE ofron mundësinë për njohjen dhe transferimin e krediteve e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda vetë universitetit dhe institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë.
2. Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik.
3. Njohja kryhet nga universiteti pranë të cilit është paraqitur kërkesa për vazhdimin e studimeve, konform kërkesave dhe standardeve të përcaktuara në rregulloren e UE-së.
4. Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren përkatëse.



5. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve, me qëllim vazhdimin e studimeve merret nga komisioni përkatës *ad hoc* i njësisë bazë dhe/ose njësisë kryesore.

Neni 59

Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies

1. Studimet në UE zhvillohen në vite akademike. Data zyrtare e fillimit të vitit akademik shpallet nga ministria përgjegjëse për arsimin.
2. Studimet zhvillohen në bazë të vitit akademik i cili organizohet në semestra, të cilat duhet të realizojnë veprimtarinë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Frekuentimi i procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimdhënëse në auditor dhe ciklit të studimit, është i detyrueshëm në një masë të caktuar, sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 60

Kohëzgjatja e studimeve

1. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.
2. Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Për këtë:
 - a. u nënshtrohet kritereve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të institucionit pritës.
 - b. kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të komisionit përkatës *ad hoc* të njësisë bazë dhe/ose njësisë kryesore, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në rregulloren përkatëse.

Neni 61

Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomës

1. Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën ose certifikatën përkatëse dhe dokumente të tjera që e shoqërojnë atë.
2. Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit shoqërohen edhe me suplementin e diplomës.
3. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedura për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin.



4. Çdo formë diplome dhe certifikate, përpara se të lëshohet nga UE, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.
5. UE nuk lëshon dublikatë diplome, por mund të lëshojë dokument të barasvlefshëm me diplomën në formën e vërtetimit, i cili duhet të përmbajë:
 - a. emrin e institucionit që ka lëshuar diplomën;
 - b. numrin e diplomës origjinale;
 - c. datën e lëshimit të saj;
 - d. ciklin dhe programin e studimit.
6. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Forma dhe përmbajtja e suplementit të diplomës që ofron UE, është sipas modelit bashkëlidhur këtij statuti.



KREU VIII KËRKIMI DHE VEPRIMTARIA SHKENCORE

Neni 62

Veprimtaria kërkimore-shkencore

1. UE kryen veprimtari kërkimore-shkencore në fusha të tilla si:
 - a) Shkencat humane dhe shoqërore;
 - b) Shkencat e natyrës;
 - c) Shkencat e edukimit;
 - d) Shkencat ekonomike;
 - e) Shkencat mjekësore teknike.
2. Veprimtaria kërkimore-shkencore realizohet përmes, studimeve, projekteve për zhvillim, si dhe veprimtarive të tjera krijuese.
3. UE garanton integrimin e veprimtarisë kërkimore në atë të mësimdhënies.
4. Veprimtaria kërkimore-shkencore në UE zhvillohet në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik, social e kulturor të vendit.
5. Nëpërmjet veprimtarisë kërkimore shkencore UE synon që:
 - a) të rrisë e të zhvillojë kapacitetet kërkimore shkencorë, duke rritur e përmirësuar kurrikulën etj;
 - b) personeli akademik të jetë i angazhuar për zhvillimin profesional dhe karrierën akademike;
 - c) studentët të rrisin aftësimin lidhur me aplikimin e metodikave të kërkimit shkencor dhe kërkime të pavarura.

Neni 63

Realizimi i kërkimit shkencor

1. Veprimtaritë e kërkimit shkencor në UE realizohen mbi bazën e programeve të kërkimit shkencor të miratuara nga Senati Akademik.
2. UE ka të drejtën të hartojë programe dhe projekte kërkimore në bashkëpunim me institucione të tjera publike ose private, brenda dhe jashtë vendit.
3. Përmes veprimtarive kërkimore shkencore, UE ofron shërbime për të tretë. Të ardhurat nga këto veprimtari përdoren për nevojat e njësisë bazë ose njësisë kryesore, sipas miratimit të Bordit të Adminstrimit.



Neni 64
Financimi i kërkimit shkencor

1. Veprimtaria kërkimore financohet nga Buxheti i Shtetit, parashikuar si zë më vete, si dhe nga burime të tjera të parashikuara në ligj.
2. Shpërndarja e fondeve për veprimtarinë kërkimore bëhet sipas prioriteteve të kërkimit shkencor.
3. Njësitë bazë dhe kryesore mbështesin dhe nxisin sigurimin e fondeve për veprimtarinë kërkimore nga burime të tjera.

Neni 65
Etika në kërkimin shkencor në UE

1. Kërkimi shkencor në UE realizohet në përputhje me Kodin e Etikës për veprimtarinë kërkimore.
2. Njësitë bazë dhe kryesore nxitin debatin aktiv për ndërgjegjësimin e shkencëtarëve për impaktet dhe implikimet e gjera që mund të kenë studimet e tyre si dhe mundësojnë komunikimin konstruktiv midis shkencëtarëve dhe publikut për sfida të ndryshme të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.
3. Autoritet dhe organet drejtuese të UE-së ndëshkojnë praktikat korruptive, të konfliktit të interesit dhe të plagjiaturës në kërkim dhe publikimin e rezultateve të kërkimit.



KREU IX STUDENTËT, TË DHËNAT, TË DREJTAT DHE DETYRIMET

Neni 66

Fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të studentit

1. Statusi i studentit fitohet me regjistrimin e tij në UE.
2. Ky status humbet me marrjen e diplomës, si dhe në rastet e çregjistrimit të studentit nga UE.
3. Studenti mund t'i pezullojë studimet dhe t'i rifillojë ato në përputhje me rregullat e përcaktuara në rregulloren e studimeve të UE.
4. Studenti nuk mund të regjistrohet, njëkohësisht, në më shumë se një program studimi. Bëjnë përjashtim nga ky nen nxënësit dhe studentët e shkëlqyer.

Neni 67

Të drejtat dhe detyrimet e studentëve

Studentët kanë të drejtë:

- a) të nënshkruajnë një kontratë me UE, në momentin e regjistrimit. Elementët e kontratës dhe forma e saj përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin;
- b) të zgjedhin dhe të zgjidhen si përfaqësues në organet vendimmarrëse të UE në nivele të Senatit 10% (dhjetë përqind) të komisioneve, sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore në fuqi;
- c) të ndjekin të gjitha veprimtaritë mësimore që zhvillohen në kuadrin e programit të studimit ku ata janë regjistruar;
- d) të përfitojnë bursë studimi kur përmbushin kushtet e parashikuara në vendimet e Këshillit të Ministrave. Studentët e shkëlqyer marrin bursë dhe shpërblime të veçanta që administrohen nga UE;
- e) të përdorin infrastrukturën që UE vë në dispozicion të procesit mësimor, si dhe të përfitojnë nga shërbimet mbështetëse që ofrohen;
- f) të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në UE.
- g) të sigurohen nga UE, në një ndër shoqëritë e sigurimit, për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të studimeve, për riskun e ndërprerjes së veprimtarisë apo risqe të tjera, sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit të financave;
- h) UE siguron mbështetje për veprimtaritë kulturore, shoqërore, sportive dhe veprimtari të tjera jopolitike të studentëve;

Të drejtat dhe detyrat e studentëve fillojnë me regjistrimin si student i UE dhe përfundojnë me dhënien e diplomës.

Studentët kanë detyrë:

- a) të zbatojnë statutin dhe rregulloret në fuqi në UE dhe në njësinë kryesore;



- b) të respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë;
- c) të paguajnë tarifën e përcaktuara me ligj dhe nga UE për shërbimet që ju ofrohen atyre;
- d) të paguajnë tarifën e shkollimit dhe shërbimeve që ofron universiteti;
- e) t'u kushtojnë vëmendjen e duhur studimeve dhe të marrin pjesë në veprimtaritë akademike;
- f) të respektojnë Kodin e Etikës së UE;

Studentit përsëritës i ndërpritet mbështetja nga fondet publike.

Neni 68

Këshillat e studentëve

1. Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentore në nivel njësie kryesore dhe nivel institucioni.
2. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve, nuk zhvillojnë veprimtari politike, ekonomike, por promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UE.
3. Këshillat e studentëve zgjidhen çdo 2 (dy) vjet nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi. Në rastet kur një individ i zgjedhur në këshillat e studentëve përfundon studimet universitare, ai zëvendësohet nga kandidati pasardhës në renditje për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhjet e fundit, deri në përfundim të mandatit të nisur.
4. Këshillat e studentëve nuk mund të organizohen me struktura të tjera politike e jopolitike jashtë UE. Modalitetet dhe procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e tyre janë pjesë e rregullores së UE-së, mbështetur edhe në propozimet e paraqitura nga studentët.
5. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të UE, për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilanci vjetorë paraprakë të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.

Neni 69

Dokumentacioni i procesit mësimor

1. UE mban në formë të shkruar:
 - a) regjistrin themeltar të studentëve edhe në formë elektronike;
 - b) regjistrin e arritjeve akademike;
 - c) regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.
2. Regjistri themeltar i studentëve është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve në një institucion të arsimit të lartë. Çdo student pajiset me një numër unik matrikullimi, që e mban deri në marrjen e diplomës ose certifikatës, i cili pasqyrohet në këtë regjister. Regjistri



themeltar depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së institucionit të arsimit të lartë. Ai plotësohet edhe në formë elektronike.

3. Regjistri i arritjeve akademike është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo student i regjistruar në institucionin e arsimit të lartë, sipas programeve të studimit. Regjistri i arritjeve akademike depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së institucionit të arsimit të lartë. Ai plotësohet edhe në formë elektronike.
4. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave është dokumenti që vërteton emetimin e tyre prej institucionit të arsimit të lartë. Institucionet e arsimit të lartë dokumentojnë tërheqjen e diplomës dhe suplementit të diplomës prej secilit student që ka përfunduar me sukses detyrimet akademike dhe ato të tjera institucionale. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së institucionit të arsimit të lartë. Ai plotësohet edhe në formë elektronike.

Neni 70

Baza e të dhënave të studentëve

1. UE ruan të dhënat personale të studentëve duke përfshirë:
 - a) gjeneralitetet;
 - b) numrin e matrikullimit;
 - c) arritjet akademike në vitet përkatëse, si dhe çdo të dhënë tjetër që ka të bëjë me studimet.
2. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga UE, kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.



KREU X **SIGURIMI I CILËSISË**

Neni 71

Sigurimi i brendshëm i cilësisë

1. UE është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë.
2. Në UE funksionon njësi e sigurimit të brendshëm të cilësisë, me fokus:
 - a) evidentimin e problematikave të lidhura me mësimin;
 - b) evidentimin dhe ndjekjen e problematikave të lidhura me cilësinë e mësimdhënies;
 - c) sigurimin e bazës së të dhënave për cilësinë e mësimdhënies;
 - d) vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore;
 - e) realizimin e studimeve për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga universiteti;
 - f) organizimin dhe ndjekjen e zhvillimit të pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi;
 - g) orientimin dhe udhëheqjen metodike të procedurave të veprimit për vlerësimin e brendshëm në njësitë bazë dhe njësitë kryesore;
 - h) vlerësimin e performancës së stafit akademik.



KREU XI
PRONAT DHE FINANCIMI I UE-së, MARRËDHËNIET ADMINISTRATIVE DHE
FINANCIARE

Neni 72
Pronat e UE-së

1. Pronat e paluajtshme në të cilat ushtron veprimtarinë e tij UE, që i shërben institucionit për të garantuar përmbushjen e misionit të tij, kalojnë në administrim të institucioneve, me Vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të ministrit përgjegjës për arsimin.
2. UE ka për detyrë të ruajë e të mirëmbajë pronat në administrim dhe përdorim, si dhe nuk mund të ndryshojë destinacionin e tyre.
3. UE ka të drejtë të zhvillojë pronat me miratim paraprak të subjektit që i ka kaluar pronën në administrim.

Neni 73
Autonomia financiare e UE-së

1. UE funksionon sipas parimit të autonomisë financiare.
2. UE harton një plan buxhetor afatmesëm, i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Ky plan përditësohet çdo vit.
3. Të gjitha të ardhurat e krijuara nga UE përdoren prej tij dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës.
4. Përdorimi i fondeve publike nga UE bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar.

Neni 74
Burimet e financimit të UE-së

1. UE financohet nga:
 - a) Buxheti i Shtetit;
 - b) pagesat e studentëve për arsimim;
 - c) të ardhurat për shërbimet e kryera;
 - d) të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta;
 - e) donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi;
 - f) veprimtari kërkimore-shkencore.
2. Të ardhurat e përfituara nga shërbimet, veprimtaritë kërkimore-shkencore, konsulencat, si dhe çdo e ardhur që realizohet nga veprimtaria ku merr pjesë personeli akademik, ndahet ndërmjet personelit akademik të UE-së, sipas rregullore së miratuar nga Bordi i Administrimit.



3. Mënyra e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat e UE-së, me përjashtim të financimeve nga Buxheti i Shtetit, do të përcaktohet në rregulloren financiare.

Neni 75

Fondet nga buxheti i shtetit

1. Fondet nga Buxheti i Shtetit detajohen në formë granti, sipas kategorive të mëposhtme:
 - a) granti i politikave të zhvillimit të UE-së;
 - b) granti i mësimdhënies;
 - c) granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.
2. Këto grante përcaktohen sipas modelit të skemës së financimit të Ministrisë së Financave dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.
3. UE ka detyrimin e aplikimit për përfitim të këtyre granteve.

Neni 76

Marrëdhëniet financiare

1. Projektbuxheti/buxheti në UE hartohet në nivel universiteti duke u bazuar në kërkesat e detajuara në nivel njësie bazë/njësie kryesore.
2. Për përgatitjen e projektbuxhetit njësitë bazë paraqesin në rektorat kërkesat, sipas afateve të përcaktuara me vendim rektorati.
3. Rektorati harton dhe paraqet për miratim projektbuxhetin në Senatin Akademik.
4. Me kërkesën e Senatit Akademik, Bordi i Administrimit miraton projektbuxhetin e universitetit.

Neni 77

Auditimi i brendshëm

1. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UE realizohen nga njësia e auditimit të brendshëm të institucionit.
2. Auditimi i brendshëm është strukturë administrative në nivel institucioni. Kjo strukturë e ushtron veprimtarinë sipas rregulloreve të funksionimit të miratuar nga Bordi i Administrimit.



KREU XII
DISPOZITA PROCEDURIALE

Neni 78
Vendimmarrja

1. Vendimmarrja në organet kolegjiale apo komisionet e UE bëhet vetëm në mbledhje të rregullta.
2. Në akt pasqyrohen detyrimisht edhe mendimet kundra.
3. Rendi i ditës dhe materiali informativ u paraqiten anëtarëve respektivë para mbledhjes sipas afateve dhe mënyrës së përcaktuar në rregulloren përkatëse, me përjashtim të rasteve që konsiderohen emergjente.

Neni 79
Krijimi i komisioneve *ad hoc* në nivel institucioni

1. Organet dhe autoritetet drejtuese të institucionit mund të krijojnë komisione për çështje të rëndësishme, mbi të cilat do të bazohet diskutimi dhe vendimi i organeve apo autoriteteve.
2. Për çështje të veçanta, organet dhe autoritetet drejtuese të institucionit mund të ftojne ekspertë të fushës së dhënë për të asistuar në diskutimet dhe në gjetjet e zgjidhjeve.
3. Komisionet mund të trajtohen financiarisht sipas legjislacionit në fuqi.



DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 80

Vula dhe stema e institucionit

1. Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", ka vulën zyrtare të tij sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Ministrave Nr. 414 datë 12.11.1991. Vula ka diametrin 40 mm, me stemën shtetërore në qendër dhe rreth saj në pjesën e lartme shënohet: "REPUBLIKA E SHQIPËRISE" "UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI", ndërsa në pjesën e poshtme shënohet ELBASAN (sipas shtojcës nr. 1, bashkëngjitur).
2. UE ka për simbol të tij stemën (sipas shtojcës nr. 2, bashkëngjitur).
3. UE ka faqen zyrtare të internetit, me adresë: www.uniel.edu.al.

Neni 81

Vazhdueshmëria

Organet dhe autoritetet në nivel institucioni i ushtrojnë funksionet deri në zgjedhjen e organeve të reja apo autoriteteve të reja.

Neni 82

Miratimi

Ky statut u miratua nga Senati Akademik i UE-së me Vendimin Nr. 5 datë 30/01/ 2018

Neni 83

Hyrja në fuqi

1. Ky statut hyn në fuqi të nesërmen e shprehjes së ministrisë përgjegjëse për arsimin lidhur me ligjshmërinë e tij.
2. Kur Ministri nuk shprehet brenda dy muajve nga data e dërgimit, statuti konsiderohet i miratuar dhe hyn në fuqi menjëherë.

Me hyrjen në fuqi të këtij statuti, statuti i mëparshëm i UE-së shfuqizohet.

